



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail:

klsh@klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 875/ 14 Prot.,

Tiranë, më 12.04.2021

V E N D I M

Nr. 40, Datë 12.04.2021

P Ë R

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA "MBI AUDITIMIN FINANCIAR" PËR PROJEKTIN
"OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE ME NË QENDËR QYTETARIN"
(për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.07.2020)**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për Projektin "Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin", për sa i takon saktësisë, vërtetësisë, besueshmërisë dhe raportimit të Raporteve Financiare (IFR) për shpenzimet e programit (EEP) të Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit, konstatohen devijime të cilat janë të përhapura por jo materiale.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të "Auditimit Financiar" të ushtruar në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për Projektin "Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin", sipas programit të auditimit nr. 875/1 prot., datë 29.09.2020, i ndryshuar me shkresën nr. 875/2 prot., datë 05.10.2020, për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datë 31.07.2020.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A: OPINIONI I AUDITIMIT FINANCIAR

Opinion i pakualifikuar me theksim çështje.

Opinion i shprehur mbi Raportet Financiare (IFR) për vitet 2018 dhe 2019.

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar Raportet Financiare (IFR) të shpenzimeve të ligjshme të programit (EEP) të cilat përfshijnë shpenzimet e llogarive 600 “Paga personeli” dhe 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” të Agjencive Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/Ish-ZRPP) për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2019. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, Manualin e Auditimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI 1000-1999), në parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe Standardeve të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 200, 2000, 2200-2810.

Në opinion tonë, bazuar në punën e kryer në auditim, është marrë siguri e arsyeshme dhe është siguruar një evidencë e mjaftueshme, e përshtatshme dhe relevante për të arritur në konkluzionin se Raportet Financiare (IFR) në aspektin material paraqesin një pamje të vërtetë dhe janë përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për raportimin financiar sipas marrëveshjes së huasë të ratifikuar me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin””. Megjithatë, grupi i auditimit tërheq vëmendje për disa çështje të rezultuara gjatë auditimit veçanërisht me keqklasifikim të gabuar të shpenzimeve për llogaritë 600-601, diferenca të rezultuara nga auditimi i shpenzimeve për llogaritë (600, 601) në Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit me shpenzimet e raportuar në Raportet Financiare (IFR) dhe për këtë arsye gjykojmë dhënien e **Opinionit të pakualifikuar me theksim çështje.**

Baza për Opinionin e pakualifikuar me theksim çështje

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e zbatimit të procedurave audituese rezulton se, opinionin e dhënë mbështetet në faktin se devijimet e konstatuara për shpenzimet e ligjshme të programit (EEP) për llogaritë (600 dhe 601) të raportuara nga Agjencitë Pjesëmarrëse (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) në zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (PMU) pranë ADISA përmbajnë gabime të cilat në gjykimin profesional të audituesve të pavarur nuk janë të përhapura dhe materiale, që justifikon dhënien e opinionit të pakualifikuar me theksim çështje.

Grupi i auditimit thekson çështjet e rezultuara të cilat nuk janë thelbësore për rezultatet e raporteve financiare IFR:

1. Klasifikim të gabuar i shpenzimeve për llogaritë (600, 601).
2. Diferenca të rezultuara nga auditimi i shpenzimeve për llogaritë (600, 601) në Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit me shpenzimet e raportuar në Raportet Financiare (IFR).
Konkretisht:

AKSHI:

- Klasifikim i gabuar i shpenzimeve të llogarisë (600) në llogarinë (601) për vitin 2019. Për llogarinë (600) janë raportuar më pak shpenzime në vlerën **5,441,439 lekë** si dhe për llogarinë (601) janë raportuar më shumë në vlerën **5,436,884 lekë**.
- Konstatohen diferenca midis vlerave të urdhër shpenzimeve, borderove të pagave dhe listë pagesave të deklaruara në sistemin tatimor, për vitin 2018 janë paguar pa dokumentacion justifikues dy punonjëse me pagë neto **154,624 lekë** si dhe në vitin 2019, janë paguar pa dokument justifikues gjashtë punonjës në vlerën **248,417 lekë**.
- Gjithashtu në vitin 2019 janë kryer shpenzime për llogarinë (601) të pajustificuara në vlerën totale **61,203 lekë**.
- Si dhe në vitin 2018, janë paguar pa dokumentacion justifikues dy punonjëse me pagë neto **154,624 lekë** si dhe në vitin 2019, janë paguar pa dokument justifikues gjashtë punonjës në vlerën **248,417 lekë**.

ASHK:

Konstatohen diferenca për të gjithë sistemin midis vlerave të shpenzime për llogaritë (600, 601) të raportuara në Raportet Financiare (IFR) dhe shpenzimeve faktike të institucionit.

- Për vitin 2018 janë raportuar më pak shpenzime (600, 601) në vlerën **77,578 lekë** si dhe për vitin 2019 janë raportuar më shumë shpenzime (600, 601) në vlerën **743,155 lekë**.

Zyrat e Gjendjes Civile:

- Konstatohen diferenca midis faktit dhe raportimeve të dërguara pranë ADISA për të gjithë sistemin për llogarinë (600) për vitin 2018 është raportuar me një diferencë më pak në vlerën **68,000 lekë**.

- Konstatohet klasifikim i gabuar i shpenzimeve, për vitin 2019 vlera e raportuar pranë ADISA përputhet me shpenzimet faktike për të gjithë sistemin për llogaritë (600, 601). Lidhur me shpenzimet e llogarisë (600, 601) ka devijime jo materiale në lidhje me klasifikimin e tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU) si dhe Agjencitë Pjesëmarrëse të Projektit (Regjistri Civil, AKSHI, ADISA dhe ASHK/ish-ZRPP) janë përgjegjëse për koordinimin e duhur, funksionimin dhe për raportimin e drejtë dhe të saktë duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe menaxhimin e Projektit duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Ndërsa Agjencitë pjesëmarrëse të cilat ofrojnë shërbime administrative, janë përgjegjëse për realizimin e shpenzimeve të ligjshme sipas programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti.

Përgjegjësitë e audituesve

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi shpenzimet e ligjshme sipas programit (EEP) për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen nga Projekti për agjencitë pjesëmarrëse. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit. Përveç Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t), ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën

audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale agjencive pjesëmarrëse të Projektit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin financiar dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në marrëveshjen e huas të ratifikuar me Ligjin nr. 3, datë 28.01.2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”” cilësohet se Huamarrësi nëpërmjet MIAP (Ish-Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike) zbaton Projektin në përputhje me Manualin Operacional sipas politikave dhe procedurave përkatëse. MIAP duhet të monitoronte dhe vlerësonte progresin e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe në bazë të treguesve të pranishëm për Bankën Financuese (IBRD). Nga auditimi rezultoi se ndryshimet në qeverisje me shkrirjen e Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP), ndryshimi i statusit të ADISA-s e cila aktualisht është institucion në varësi të Kryeministrisë dhe ndryshimi i formës ligjore të funksionimit të institucioneve të tjera të përfshira në implementimin e Projektit, siç është rasti i ish-ZRPP (aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës) nuk janë pasqyruar në Manualin Operacional të Projektit (MOP). MOP i cili parashikon politikat dhe procedurat që përdoren për të realizuar projektin, duke përfshirë ndër të tjera rolet dhe përgjegjësitë e Agjencive Pjesëmarrëse dhe entiteteve të përfshira në projekt nuk ka të përditësuar institucionet e përfshira, procedurat për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Projektit, duke përfshirë procedurat e përcaktuara qartë në lidhje me verifikimin dhe përpunimin e pagesave. Mos përcaktimi i saktë i procedurave që duhet të ndiqen për të realizuar projektin ndikon në menaxhimin financiar të realizimit të tij dhe në mos evidentimin e përgjegjësive në rastin e verifikimit të pagesave dhe regjistrimin e shpenzimeve të miratuara të financuara nga të ardhurat e Huasë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 20-26 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: ADISA në rolin e njësisë së menaxhimit të projektit, për të gjitha projektet me financime të huaja, të cilat do të menaxhohen nga ana e saj në të ardhmen, të marrë masa dhe të reflektojë në kohë reale, ndryshimet e funksionimit të strukturave të përfshira në projekt me qëllim adresimin e saktë gjatë periudhës së implementimit të projektit, shmangien e keqkuptimeve dhe evidentimin e përgjegjësive.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, është konstatuar se nuk kanë funksionuar strukturat drejtuese të cilat duhet të ngriheshin për realizimin e projektit, konkretisht:
- Komiteti Drejtues i Projektit,

- Grupet ministrore të punës, të kryesuar nga MIAP,
- Qendra e Shërbimeve Publike.

Mos funksionimi i këtyre strukturave ka ndikuar në mospërmbushjen e detyrimeve në lidhje me Projektin. Komiteti Drejtues në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr. 3, datë 28.01.2016, shtojca 2 nuk është mbledhur të paktën një herë në tre muaj për të bërë mbikëqyrjen e menaxhimit të projektit, përfshirë ndër të tjera, monitorimin e zbatimit të projektit, heqjen e pengesave, si dhe sigurimin e shkëmbimit të informacionit midis Agjencive Pjesëmarrëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 20-26 të Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Huamarrësi, nëpërmjet strukturave drejtuese më të larta të përfshira në projekt, të marr masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe analizimin e shkaqeve për mos funksionimin e strukturave drejtuese të Projektit si dhe në të ardhmen për projekte të ngjashme, të sigurohet funksionimi i tyre gjatë gjithë zbatimit të projektit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, *Komiteti Drejtues i Projektit dhe Grupet ministrore të punës*, nuk kanë funksionuar dhe nuk kanë mbikëqyrur menaxhimin e projektit duke përfshirë ndër të tjera dhe sigurimin e shkëmbimit të informacionit midis Agjencive Pjesëmarrëse. Mungesa e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Agjencive Pjesëmarrëse u evidentua edhe gjatë auditimit të programit të shpenzimeve të llogarive 600 dhe 601, ku, dy nga subjektet përfituese të projektit, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Zyrave të Gjendjes Civile (Ministria e Brendshme) dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) shprehen se nuk ishin në dijeni të këtij projekti, nuk raportnin dhe as nuk shkëmbejnë informacion me PMU në lidhje me shpenzimet e kryera për komponentin 1 të programit të financimit. Për programin e shpenzimeve të miratuar në Institucione buxhetore si Ministria e Brendshme, AKSHI dhe Agjencia për ofrimin e shërbimeve të integruara në Shqipëri (ADISA), Njësia e Menaxhimit të Projektit i merr të dhënat dhe bën rakordimet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit Tiranë.

Për sa i përket Programit të shpenzimeve të pranuar për Institucione publike jo-buxhetore, siç është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme aktualisht ASHK, ky i fundit ka mbajtur korrespondencë dhe raportin periodikisht tek ADISA në lidhje me shpenzimet e llogarive 600 dhe 601. Kjo mungesë bashkëpunimi dhe mos rakordimi ndërmjet *agjencive pjesëmarrëse dhe entiteteve të përfshira në Projekt* në lidhje me shpenzimet e kryera për komponentin 1 të programit të financimit, është në kundërshtim me pikën 5 të Seksionit 1/A të ligjit nr. 3, datë 28.01.2016 dhe Manualin Operacional të Projektit, kapitulli II. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II. 2.1, faqe 20-26 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Njësia e menaxhimit të projektit, të marrë masa që deri në përfundim të projektit, për programin e shpenzimeve të pranuar (EEP) i cili mbulon komponentin 1 të programit të financimit, të rakordojë me të gjitha Agjencitë përfituese të këtij Projekti për konkludimin e vlerës së saktë të shpenzimeve për gjithë kohëzgjatjen e Projektit *(për efekt raportimi)* dhe në rast mos raportimi apo mos rakordimi nga ana e tyre të informojë institucionin e tij të varësisë.

Në Vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për kategorinë e parë, Programi i shpenzime të miratuara sipas pjesëve 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit është planifikuar Vlera 22,895,000 EUR. Ky program përfshinë shpenzimet për mbështetjen e Buxhetit të Shtetit (EEP) dhe do të disbursohet sipas një grafiku të

caktuar pas realizimit të 5 DLI-ve (*Disbursement Linked Indicators*). Deri në 31.07.2020, nga 5 DLI të parashikuara në vlerën totale 22,895,000 Euro, rezulton se është disbursuar vlera totale 19,295,000 Euro, ose 84,2% si dhe kanë mbetur pa disbursuar vlera 3,600,000 Euro pasi nuk ka përfunduar realizimi i 5 DLI-ve.

Gjithashtu nga auditimi i DLI-ve të realizuara dhe të disbursuara respektivisht për secilin vit rezultoi se nuk janë respektuar afatet kohore të përcaktuara në marrëveshje për realizimin e tyre pasi një pjesë e numrit të shërbimeve publike të përcaktuara për secilën DLI nuk kanë arritur të realizohen në kohë.

Konkretisht për secilin vit për periudhën objekt auditimi janë disbursuar DLI-t si më poshtë:

-Për vitin 2018, është parashikuar disbursimi i DLI 1 në vlerën 900,000 Euro, DLI 2 në vlerën 900,000 Euro, DLI 3 në vlerën 900,000 Euro dhe DLI 4 në vlerën 500,000 Euro. Nga auditimi ka rezultuar se në vitin 2018 është disbursuar DLI 1 parashikuar për vitin 2016 në vlerën 2,750,000 Euro, DLI 1 parashikuar për vitin 2017 në vlerën 1,800,000 Euro, DLI 3 parashikuar për vitin 2017,2018 dhe 2019 në vlerën 2,800,000 Euro.

-Për vitin 2019, është parashikuar disbursimi i DLI 1 në vlerën 900,000, DLI 2 në vlerën 900,000, DLI 3 në vlerën 500,000, DLI 4 në vlerën 500,000. Nga auditimi rezultoi se në vitin 2019 është disbursuar DLI 4 e parashikuar për vitin 2017,2018, 2019, 2020 në vlerën 2,000,000 Euro.

-Për periudhën janar - korrik 2020, është parashikuar disbursimi i DLI 3 në vlerën 500,000 Euro dhe DLI 4 në vlerën 500,000 Euro. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2020 është disbursuar vetëm DLI 3 parashikuar për vitin 2020 në vlerën 500,000 Euro. Realizimi i DLI-ve dhe disbursimi i tyre në kohë është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e projektit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II. 2.2, faqe 27-34 të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Njësia e Menaxhimit të Projektit, si dhe Agjencitë pjesëmarrëse përgjegjëse për realizimin e projektit të marrin masat për ndjekjen dhe realizimin në kohë të detyrimeve të përcaktuara për realizimin e DLI-ve të porealizuara dhe disbursimeve përkatëse me qëllim përmbjlljen e projektit “Shërbime publike me në qendër qytetarin” brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas të ratifikuar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën e viteve 2018-2019, Bankës nuk i është dërguar raporti financiar i ndërmjetëm për 3-mujorin e tretë të vitit 2019 (01.07.2019-30.09.2019), ndërsa raporti financiar i ndërmjetëm për 3-mujorin e dytë të vitit 2018 (01.04.2018-30.06.2018) i është dërguar më 25.10.2018, jashtë afatit të përcaktuar në shtojcën 2 të Marrëveshjes, ku parashikohet *se Huamarrësi duhet të marr masa që të mbaj një sistem menaxhimi financiar, si dhe të përgatisë raporte financiare të ndërmjetme të pa audituara për Projektin që mbulojnë atë semestër raportimi, në një formë dhe me një përmbajtje të pranueshme nga Banka dhe t’ia dërgojë asaj jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik*. Referuar marrëveshjes së Huas me Bankën (IBRD) seksioni IV, shtojca 2, mungesa e këtyre raporteve të ndërmjetme për shpenzimet e pranueshme (*të cilat lidhen me realizimin DLI*) apo mos hartimi i tyre në afat sjellë vonesa në realizimin e procesit të disbursimit.

Gjithashtu edhe në lidhje me raportimet mujore të dërguara nga PMU në MF konstatohet se në 7 raste është raportuar jashtë afateve të parashikuara me vonesë deri në 5 ditë, ndërsa për 1 rast nuk është raportuar fare, konkretisht për muajin Gusht 2019 nuk ka raportim. Në kundërshtim me Udhëzimin nr.8 datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e Huaj”, pika.5.5,

brenda datës 5 të çdo muaji, çdo njësi e zbatimit të projekteve duhet të paraqesë në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave, situacionin e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin paraardhës, progresiv për projektet respektive që ato mbulojnë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqen 27-34 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: ADISA në cilësinë e njësisë së menaxhimit të projektit, për të gjitha projektet me financime të huaja të cilat do të menaxhohen nga ana e saj në të ardhmen, të marrë masa që të hartojë dhe realizojë në kohë raporte financiare të ndërmjetme drejtuar Bankave financuese dhe raporte të tjera drejtuar Ministrisë së Financave sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje me qëllim shmangien e vonesave në procesin e disbursimit dhe evidentimin e përdorimit të huasë për efekt raportimi të treguesve buxhetorë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve dhe evidencave të rakordimit me Drejtorinë e Thesarit për vitin 2018 dhe 2019, në AKSHI, konstatohet se për vitin 2019 për llogarinë 600 “Shpenzime page” janë raportuar më pak shpenzime të realizuara, në vlerën 5,441,439 lekë si dhe për llogarinë 601 “Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore” janë raportuar më shumë shpenzime të realizuara, në vlerën 5,436,884 lekë.

Kjo ka rezultuar pasi në urdhër shpenzimet e vitit 2019, konkretisht në muajt Qershor - Nëntor edhe pse llogaria ekonomike është 600, nënlllogaria ekonomike e detajuar në urdhër shpenzim është 601 duke bërë që gjatë regjistrimit të shpenzimeve në sistemin SIFQ, shpenzimet e llogarisë 600 për “Shpenzime pagash” të klasifikohen gabimisht në llogarinë 601 “Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore”. Ky klasifikim i gabuar është mbartur dhe në evidencat mujore me Drejtorinë e Thesarit duke sjell si rezultat që vlerat e raportuara për llogarinë 600 dhe 601 mos të pasqyrojnë informacion të drejtë në kundërshtim me Nenin 11, Klasifikimi buxhetor ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: AKSHI/Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e Thesarit të ri-klasifikojnë këto shpenzime duke rakorduar dhe një herë të dhënat për shpenzimet e realizuara të institucionit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarrëve të eksportuar nëpërmjet sistemi elektronik Alpha në AKSHI, rezultoi se ditarrët e bankës nuk paraqesin informacion të qartë dhe të plotë lidhur me shpenzimet. Konkretisht, në ditarrët e eksportuar nuk mund të evidentoheshin shpenzime pagash për muajin shkurt si dhe në muajin nëntor mungon hedhja e urdhër shpenzimit nr. 718 datë 04.11.2019. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, nenin 6, 17 dhe 18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: AKSHI/Drejtoria e Financës të marrë masat për regjistrimin sistematik të shpenzimeve në ditarrët elektronik të shpenzimeve, kjo duke siguruar rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre nëpërmjet mbajtjes së dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të ADISA, konkretisht në pasqyrën e performancës për vitet 2018 dhe 2019 është konstatuar se, është regjistruar më tepër në llogarinë 600 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” shuma prej 1,821,876 lekë, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet shpenzimeve për pagesat e kontributeve të rillogaritura dhe shpenzimit të paraqitur në pasqyrën financiare, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 9, pika 1, neni 10, pika 1, si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” neni 16, germa a, b, c, d dhe e si dhe pika 4, germa a. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: ADISA/Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave në pasqyrat financiare të viti 2020, të bëhet sistemimi i vlerës 1,821,876 lekë, e cila ka të bëjë me kontabilizim dhe paraqitje të gabuar në llogarinë (601) kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të kryera për konsulencë për vitet ushtrimore 2018 dhe 2019, sistemimi të bëhet referuar trajtimit kontabël dhe funksionimit të llogarive të grupit 20 “Aktive afatgjata jomateriale”.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Raporteve Financiare (IFR) të Projektit, konstatohen diferenca midis faktit dhe raportimeve të dërguara pranë ADISA/PMU nga ASHK/Ish-ZRPP për periudhën e audituar konkretisht, për vitin 2018 është raportuar me një diferencë më pak në vlerën 77,578 lekë si dhe për vitin 2019 me një diferencë më tepër në vlerën 743,155 lekë. Këto diferenca janë hasur nga DPASHK/ish-ZQRPP gjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitet 2018 dhe 2019 për të gjithë sistemin, ku është bërë edhe sistemimi i tyre në pasqyrat financiare. Lidhur me këtë situatë ASHK/ish-ZRPP nuk ka pasur korrespondencë me ADISA/PMU, ku të trajtohej problematikat e hasura për sa i përket mos rakordimit të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të raportuara për llogaritë (600, 601) për të gjithë sistemin, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 3/2016, datë 28.01.2016, për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, shtojca nr. 4, si dhe Manuali Operacional i Projektit, kapitulli 7 “Menaxhimi financiar”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: ASHK/Drejtori i Përgjithshëm dhe Njësia e Financës në vijim të zbatimit të Projektit të marrë masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse, duke shmangur të gjitha praktikatat penguese për paraqitjen dhe raportimin e saktë për shpenzimet e realizuara të programit EEP për llogaritë (600, 601) pranë ADISA/PMU.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në ASHK për shpenzimet e ligjshme të programit EEP për llogaritë (600, 601) të cilat mbulohen me financim nga Projekti konstatohet se, llogaritja e pagave dhe shpërblimeve nuk mbahet në program financiar, por në Excel dhe hidhet me veprim ekstra kontabël. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: ASHK/Drejtori i Përgjithshëm dhe Njësia e Financës, të marrë masa për mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike duke përfshirë dhe sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me

ekzekutimin e buxhetit, pagat, të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike, të dhëna për raporte financiare dhe statistika etj.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, në lidhje me shpenzimet e llogarisë 600 dhe 601, të punonjësve të Zyrave të Gjendjes Civile (programi buxhetor 1170), në kuadër të Projektit “*Ofrimi i shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin*”, u konstatua si në vijim:

✓ Për vitin 2018, vlera që i është raportuar Bankës Botërore nga ana e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike për llogarinë 600 rezulton 331,445 mijë lekë ndërsa në programin buxhetor 1170 në sistemin AMoFSTS rezulton 331,513 mijë lekë, pra është raportuar 68 mijë lekë më pak se shpenzimet faktike. Për shpenzimet e llogarisë 601 vlera e raportuar prej 55,946 mijë lekësh përputhet me shpenzimet faktike të programit buxhetor 1170, sipas sistemit AMoFSTS.

✓ Për vitin 2019, vlera që i është raportuar Bankës Botërore nga ana e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike për llogarinë 600 rezulton 334,263 mijë lekë dhe përputhet me programin buxhetor 1170 në sistemin AMoFSTS. Për shpenzimet e llogarisë 601 vlera e raportuar prej 55,578 mijë lekësh përputhet me shpenzimet faktike të programit buxhetor 1170, sipas sistemit AMoFSTS.

✓ Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve financiare për llogarinë 600 dhe 601, për punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile në 4 Bashki (Bashkia Korçë, Durrës, Fier, Vlorë) u konstatua se: *fondet e alokuara nga ana e Ministrisë së Brendshme, për punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile, programi buxhetor 1170, në Bashkinë Fier nuk kanë qenë të mjaftueshme.*

Për shpenzimet e llogarisë 600 dhe 601 të punonjësve të Zyrës së Gjendjes Civile, kjo Bashki ka përdorur fondet e veta nga programi 0 1110, kapitulli 05.

U konstatua gjithashtu se: Nga ana e Bashkisë Fier dhe Durrës është përdorur teprica e llogarisë 601 (sigurime shoqërore dhe shëndetësore) për të mbuluar shpenzimet e llogarisë 600 (paga), për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme në llogarinë 600. Kjo ka sjellë një pasqyrim jo të drejtë dhe real të këtyre 2 llogarive për sa rezulton në data bazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, në kundërshtim me Nenin 11, Klasifikimi Buxhetor, Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër në lidhje me shpenzimet e llogarisë 600 dhe 601 për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, shprehem se vlera e raportuar për vitin 2018 dhe 2019, nuk është pasqyrim i saktë dhe i drejtë, pasi është cënuar saktësia, klasifikimi dhe rregullsia, pra pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim.

Për llogarinë 600 dhe 601 vlera e raportuar e programit buxhetor 1170 nuk përputhet me shpenzimet faktike për vitin 2018 dhe 2019, pasi nuk është verifikuar/konstatuar përdorimi ose jo i fondit shtesë nga ana e Bashkive.

Pjesa e mbuluar nga vet Bashkitë ka pamundësi auditimi dhe nxjerrje nga data baza e Përgjithshme e Thesarit për arsyen se është mbuluar nga programi 0 1110, kapitulli 05, që përfshin programin e njësisë shpenzuese të vet Bashkisë, në total për gjithë punonjësit e saj.

Gjithashtu grupi auditimit nuk mund të vlerësojë dhe të shprehet për paraqitjen e llogarisë 600 dhe 601 në pasqyrat financiare sepse në pasqyrë paraqiten vlerat e llogarisë 600 dhe 601 për të gjithë punonjësit e Bashkisë, dhe jo si zë më vete.

Me Ministrinë e Brendshme kanë munguar komunikimet dhe rakordimet në lidhje me shpenzimet e faktike të llogarisë 600 dhe 601 për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile nga ana e

Agjencisë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 dhe në pikën II.2.4 faqe 70-95 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, për efekt raportimi në kuadër të Projektit “Ofrimi i shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin”, të marrin masa për konkludimin e vlerës së saktë të shpenzimeve të llogarisë 600 dhe 601 për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile duke llogaritur edhe përdorimin e fondeve të vet Bashkisë nëse ka pasur për vitin 2018-2019.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje, në 4 Bashki (Bashkia Korçë, Durrës, Fier, Vlorë) është konstatuar se:

-Nuk është bërë verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar për punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile. Në kundërshtim me VKM nr.187 datë 08.03.2017, e cila nuk parashikon pozicione pune me arsim të mesëm, në Zyrat e Gjendjeve Civile u konstatuan punonjës me këtë kualifikim. Në kushtet e mosparashikimit të pozicioneve të punës me arsim të mesëm në këtë VKM, kjo situatë ka sjellë problematika të reflektuara edhe në interpretimin e pagave të tyre. Këta punonjës janë trajtuar dhe paguar sipas përcaktimeve në VKM Nr.717 datë 23.06.2009, i ndryshuar, si punonjës mbështetës të Institucionit, duke përfituar vjetërsi 1% mbi çdo vit pune. Sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore është punonjës me status nëpunësi civil. Për sa më sipër, trajtimi i tyre si punonjës mbështetës bie në kundërshtim me Ligjin nr.152/2013.

-Nuk ka një rregullore apo udhëzim të miratuar në lidhje me përcaktimin e pagave të punonjësve të ish-Komunave. Këta punonjës vazhdojnë të paguhën sipas përcaktimit të pagës për pozicionin “përgjegjës zyre në komuna” dhe “specialist të zyrës së gjendjes civile në komuna”, jo në përputhje me përcaktimin “njësi administrative” të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nga auditimi konstatohet se fondi i çelur për llogarinë 600 dhe 601 nga Ministria e Brendshme nuk ka qenë i mjaftueshëm për përbalimin e shpenzimeve të këtyre llogarive gjatë vitit 2018 dhe 2019. Në të tilla kushte, diferenca e shpenzimeve, afërsisht 5% e totalit, është mbuluar nga fondet e vet Bashkisë. Konstatohet një mungesë analize për zërin 600 dhe 601, në lidhje me fondin e çelur, i cili në fund të vitit reflektohet në përgjithësi me tepicë në llogarinë 601 dhe mungesë në llogarinë 600, duke mos marr në konsideratë kërkesat për fonde shtesë të Bashkive.

Dërgimi i të njëjtit fond pothuajse çdo vit gjykohet si një risk i mosmarrjes në konsideratë të elementëve (shtesa, pikësime, mungesa, shtese vjetërsie, etj.) në kundërshtim me Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kreu VII Funksionet dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes vendore, Neni 21 “Llojet e funksioneve”, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 dhe në pikën II.2.4 faqe 70-95 të Raportit të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të marrë masa për trajtimin dhe adresimin e problematikave të mësipërme me qëllim mbarëvajtjen dhe mirëfunksionim e punës në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe në bashkëpunim me Strukturat e Financës në Bashki të merren masa për një planifikim të drejtë të fondeve të programit buxhetor 1170 dhe alokim në përputhje me nevojat e secilës njësi shpenzuese.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i kryer mbi transaksionet financiare në lidhje me shpenzimet e llogarisë 600 (shpenzime page) dhe llogarisë 601 (shpenzime sigurime shoqërore dhe shëndetësore), në Bashkinë Fier u konstatua një punonjës i cili është paguar me pagë bazë grupi 10,000 lekë (diplomë Bachelor) ndërkohë që nga auditimi i kualifikimit të tij në dosjen personale rezulton më diplomë Master Shkencor dhe duhej paguar me 14,000 lekë pagë bazë grupi, veprim ky në kundërshtim me VKM Nr.187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", lidhja 9. Si rrjedhojë, për periudhën e auditimit 2018-2019, nga Drejtoria e Financës, ky punonjës është paguar 96,000 lekë më pak. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 dhe në pikën II. 2.4 faqe 70-95 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkinë Fier të marr masa për llogaritjen e saktë të detyrimit, për të gjithë periudhën e paguar gabim dhe të bëjë likuidimin në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr.187 datë 08.03.2017.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 220 transaksioneve për shpenzime pagash dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2018 dhe 2019, si dhe krahasimi i dokumentacionit të urdhër shpenzimeve, borderove të pagave dhe listë pagesave të deklaruara në sistemin tatimor në AKSHI rezultuan diferenca për shpenzime pagash në vlerën 464,244 lekë . Konkretisht në vitin 2018, janë paguar pa dokumentacion justifikues (listë prezenca) dy punonjëse me pagë neto 154,624 lekë si dhe në vitin 2019, janë paguar pa dokument justifikues (listë prezenca) gjashtë punonjës në vlerën 248,417 lekë, diferenca këto që pasqyrohen me tepri në llogaritë 600 të secilit vit. Gjithashtu në vitin 2019 rezultuan se janë kryer shpenzime për kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pajustificuara në vlerë totale 61,203 lekë në kundërshtim me pika 69, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 35-69 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga AKSHI/Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore pas inicimit nga ana e tyre për njoftimin e punonjësve referuar shkresës nr. 4060/7 datë 20.11.2020, dërguar në KLSH, të vijojnë me arkëtimin e të gjitha diferencave në pagë dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 464,244 lekë të rezultuara nga auditimi. Konkretisht të vijojnë procedurat për arkëtimin vlerave nga punonjësit si më poshtë:

- A. L. në vlerën 77,312 lekë;
- E. B. në vlerën 77,312 lekë;
- A. M. në vlerën 31,679 lekë;
- M. H. në vlerën 6,739 lekë;
- O. B. në vlerën 50,055 lekë;
- O. Xh. në vlerën 87,900 lekë;
- A. Q. në vlerën 2,971 lekë;
- M. M. në vlerën 78,738 lekë;
- Mbajtja e Kontribute dhe TAP të paguar më tepër në sistemin tatimor për punonjëset: E. B., I. V. dhe A. I.

D. MASA DISIPLINORE

Nisur nga parregullsitë e konstatuara të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Drejtorit Ekzekutiv të ADISA, të përcjelli pjesët përkatëse të raportit drejt Agjencive pjesëmarrëse të projektit “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, për vlerësimin e shkeljeve të evidentuara dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse, referuar Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe Ligjit 152/2013, datë 30.05.2013, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, i ndryshuar.

E. TË TJERA

Duke qenë se auditimi i ushtruar në ADISA për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin” ishte i fokusuar në marrëveshjet e financimit, menaxhimin financiar të projektit për periudhën e audituar nga data 01.01.2018 deri më 31.07.2020, si dhe raportimit të llogarive 600 “Paga personeli” dhe 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” për periudhën e audituar nga data 01.01.2018 deri më 31.12.20219, KLSH në vijim do të kryej pranë këtij institucioni një auditim Financiar dhe/ose Përputhshmërie për çështjet dhe periudhat e pambuluara me auditim për këtë Projekt.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

K R Y E T A R

Arben SHEHU